

Vendim nr. 213 datë 30.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 30.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (T) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **TOM DEDAJ**, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ndoj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3799 (3894), datë 28.10.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 14, datë 27.02.2023 të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Shfuqizimi i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

Shfuqizimi i urdhrit nr. 475, datë 11.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.

Konstatimi i diskriminimit të kërkuarit (viktimës).

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 32, 42, 43, 49, 50, 51, 71, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8, 11 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 68 dhe 72 të ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrë për periudhën 01.12.2013 deri më 28.01.2019, kur është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 22 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për shkak të këtij funksioni, kërkuar ka pasur detyrimin për deklarimin e interesave privatë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*ILDKPKI*), sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar (*ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive*).

2. Me urdhrin nr. 783, datë 12.09.2022 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së është kryer kontroll i plotë i deklaratave të interesave privatë të kërkuarit për vitet 2017 dhe 2018, si dhe i deklaratës pas largimit nga funksioni, e vitit 2019. Për qëllim të këtij kontrolli, ILDKPKI-ja ka vlerësuar nevojën që kërkuar të paraqitet pranë institucionit me qëllim sqarimin e problematikave të konstatuara gjatë kontrollit dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës justifikues. Konkretisht, me shkresën nr. 2782/25 prot., datë 07.12.2022, kërkuar është thirrur për t’u paraqitur në ILDKPKI. Kërkuar nuk është paraqitur, por me shkresën e datës 09.12.2022 i ka kërkuar ILDKPKI-së sqarime shtesë dhe kopje të dokumentacionit ku bazohej kërkesa për t’u

paraqitur e për të dhënë shpjegime. Në vijim, me shkresën nr. 2782/25 prot., datë 26.01.2023, kërkuesi është thirrur sërish për t'u paraqitur pranë ILDKPKI-së për të dhënë shpjegime për problematika të dala gjatë kontrollit. Kërkuesi nuk është paraqitur as kësaj here dhe, me shkresën e datës 31.01.2023, i ka kërkuar ILDKPKI-së që t'i dërgohen me shkrim problematikat e konstatuara dhe shtyrjen e datës së paraqitjes pas datës 15.02.2023.

3. Në këto kushte, në bazë të nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe pikës 2 të urdhrit nr. 475, datë 11.05.2017 “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”, në të cilin detajohen se cilat janë shkeljet e tjera sipas ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive (*urdhri nr. 475/2017*), Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, me vendimin nr. 14, datë 27.02.2023 “Për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë”, ka vendosur marrjen e masës administrative “gjobë” në shumën 200.000 lekë ndaj kërkuetit (*vendimi nr. 14/2023*), me motivacionin e mosparaqitjes së tij të vazhdueshme për të dhënë shpjegime pranë institucionit.

4. Në datën 27.03.2023 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 14/2023 të ILDKPKI-së. Gjatë procesit gjyqësor kërkuesi ka kërkuar shtimin e objektit të padisë edhe me kërkesën për deklarimin e paligjshëm të pikës 2 të urdhrit nr. 475/2017 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në seancën e datës 12.03.2024 gjykata e ka rrëzuar atë kërkesë, duke arsyetuar se në rastin konkret kërkesa për shtimin e objektit të padisë përbën padi të re, si dhe nisur nga natyra e urdhrit nr. 475/2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka kompetencë funksionale për shqyrtimin e saj. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se pretendimet e kërkuetit për paligjshmërinë e atij urdhri mund të merren në shqyrtim nga ana e gjykatës vetëm referuar nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*), pra në kushtet e gjykimit incidental. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shqyrtuar edhe kërkesën e kërkuetit për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes dhe, me vendimin nr. 3619, datë 24.10.2024, ka vendosur rrëzimin e asaj kërkesë.

5. Për themelin e çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3799 (3894), datë 28.10.2024, ka vendosur rrëzimin e padisë për shfuqizimin e vendimit nr. 14/2023 të ILDKPKI-së. Ajo gjykatë është shprehur se vendimi i saj është i formës së prerë sipas nenit 45, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012 dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi, pasi vlera e gjobës për

kryerjen e kundërvajtjes administrative është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar në vendimin nr. 113, datë 01.03.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i zbatueshëm në datën e dhënës së vendimit.

6. Në datën 06.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë, ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe urdhri nr. 475/2017 i ILDKPKI-së i kanë cenuar këto të drejta kushtetuese:

7.1. *Për procesin gjyqësor*

7.1.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

7.1.1.1. *Së drejtës së ankimit*, për shkak të disponimit të gjykatës së shkallës së parë për mosankimin e vendimit në një gjykatë më të lartë.

7.1.1.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi duke rrëzuar kërkesën për shtimin e objektit të padisë dhe atë për përjashtimin e gjyqtarit, gjykata e shkallës së parë e ka paragjykuar çështjen e tij.

7.1.1.3. *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi kërkuesi është diskriminuar nga ILDKPKI-ja për shkak të përkatësisë fetare, politike dhe krahinore ose për shkak të detyrës që ka pasur, e cila e ka gjobitur dy herë atë në të njëjtat kushte, për të njëjtën arsye dhe pa asnjë shkak, pa asnjë shkelje. Edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe kushtetues e kanë diskriminuar kërkuesin, të cilat në vijimësi rrëzojnë ose nuk pranojnë kërkesat e tij.

7.1.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar vendimin e saj dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit.

7.1.1.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e shkallës së parë padrejtësisht ka miratuar sjelljen e ILDKPKI-së, e cila, në mënyrë të pakuptimtë, pa bazë ligjore dhe jashtë çdo afati, e ka gjobitur kërkuesin, edhe pse ai nuk është më subjekt kontrolli nga ai institucion.

7.2. Për ligjin dhe aktin nënligjor

7.2.1. Neni 40 i ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ku bazohet edhe urdhri nr. 475/2017 i ILDKPKI-së, bie ndesh me nenin 32 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes. Për më tepër, ligji në tërësinë e tij nuk ka parashikuar afate për konstatimin e shkeljeve dhe parashkrimin e tyre, nuk ka parashikuar si do të trajtohen rastet e personave që nuk janë më subjekte deklarimi dhe as parashikime të tjera të rëndësishme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Gjithashtu, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kërkesi legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kriterë: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore; ka paraqitur ankim kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin për çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

10. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është: (i) shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe i vendimit nr. 14/2023 të ILDKPKI-së; (ii) shfuqizimi i nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe i urdhrit nr. 475/2017 të ILDKPKI-së. Prandaj, në zbatim të standardeve kushtetuese të lartpërmendura, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor administrativ në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi në Gjykatë, gjatë të cilit (procesit) është shqyrtuar kërkesëpadia e tij për shfuqizimin e vendimit të ILDKPKI-së, me bazë ligjore nenin 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe pikën 2 të urdhrit nr. 475/2017 të ILDKPKI-së.

11. Një tjetër kriter paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual, me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike efektive që parashikon sistemi ynë juridik. Meqenëse mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit,

efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012, vendimi nr. 3799 (3894), datë 28.10.2024 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është përfundimtar dhe i paankimueshëm në rrugë gjyqësore për shkak të vlerës së ulët monetare të masës administrative të gjobës. Një fakt i tillë është arsyetuar edhe nga gjykata (*shih paragrafin 34 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*), e cila ka disponuar edhe në dispozitiv se ky është një vendim i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e këtij vendimi, shfuqizimin e vendimit të ILDKPKI-së për vendosjen e masës administrative, nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe urdhrin nr. 475/2023, në bazë të të cilëve është nxjerrë akti administrativ i kundërshtuar. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Po kështu, neni 50, pika 4, i po këtij ligji, parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën, ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual, konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ.

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i formës së prerë, ku është zbatuar neni i kundërshtuar, mban datën 28.10.2024. Kërkuesi pretendon se ka marrë dijeni për vendimin në datën 01.04.2025, në të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përgjigje të kërkesës së tij, i ka dërguar atij kopje të vendimit. Ndërkohë, sipas informacionit të gjykatës administrative të shkallës së parë, të përcjellë me shkresën nr. 12790/1 prot., datë 25.07.2025, këto vendime nuk u komunikohen palëve me dëftesë komunikimi, sikurse procedohet për vendime për të cilat lejohet e drejta e ankimit.

16. Bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson se në situatën që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ia ka komunikuar vendimin kërkuesit, konsiderohet se momenti në të cilin ai ka marrë dijeni efektivisht për përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar është data

01.04.2025. Për rrjedhojë, referuar kësaj date, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i depozituar në datën 06.05.2025 është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor. Prandaj kërkesa e përmbush edhe këtë kriter si për kërkimin për shfuqizimin e vendimeve, ashtu edhe për shfuqizimin e ligjit dhe të urdhrit të ILDKPKI-së.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së ankimit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të mosdiskriminimit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe sigurisë juridike. Kërkuesi ka kërkuar edhe shfuqizimin e nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të pikës 2 të urdhrit nr. 475/2023 të ILDKPKI-së, në bazë të të cilëve është nxjerrë vendimi nr. 14/2023 për vendosjen e masës administrative ndaj kërkuetit, pasi bie ndesh me nenin 32 të Kushtetutës.

18. Pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit kërkuesi e ka lidhur me disponimin e gjykatës së shkallës së parë për mosankimin e vendimit në një gjykatë më të lartë. Kolegji evidenton se sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohe kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese ka gjetur pasqyrim edhe në dispozitat e ligjit nr. 49/2012, neni 45 i të cilit parashikon se “*nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi, me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; ...*”. Kjo do të thotë se rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se, në kundërshtim me sa pretendohet nga kërkuesi, e drejta e ankimit nuk është absolute dhe Kushtetuta ka vendosur kufizimin e kësaj të drejte, në varësi të vlerës së objektit të padisë. Në këto kushte, përderisa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar mbi vlerën e objektit të padisë dhe kërkuesi nuk ka pretendime për këtë vlerë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

19. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuesi ka argumentuar se gjykata ka rrëzuar kërkesën për shtimin e objektit të padisë dhe atë për

përfundimin e gjyqtarit, duke paragjykuar çështjen e tij. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se në seancën e datës 12.03.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shtimin e objektit të padisë, duke arsyetuar se, në rastin konkret, ajo përbënte padi të re dhe se nisur nga natyra e urdhrit nr. 475/2023, ajo gjykatë nuk kishte kompetencë funksionale për shqyrtimin e saj. Ajo gjykatë ka evidentuar se pretendimet e kërkuarit për paligjshmërinë e atij urdhri mund të merreshin në shqyrtim nga ana e gjykatës vetëm referuar nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, pra në kushtet e gjykimit incidental. Kolegji vlerëson se vetëm argumenti i rrëzimit të kërkesës për shtimin e objektit të padisë nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të provuar cenimin e parimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për sa kohë që kërkuari nuk ka parashtruar ndonjë argument të qenësishëm në këtë drejtim. Për më tepër, pretendimi i kërkuarit për paanshmëri është marrë në shqyrtim nga një tjetër gjyqtar i asaj gjykate, i cili e ka gjetur atë të pabazuar. Edhe argumenti se nëpërmjet rrëzimit edhe të kësaj kërkesë është treguar njëanshmëri, vlerësohet nga Kolegji si haptazi i pabazuar, për sa kohë që gjatë marrjes së vendimit për rrëzimin e kërkesës për përfundim nuk rezultoi që gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesën të këtë bërë vlerësime që lidhen me themelin e çështjes dhe zgjidhjen e konfliktit mes palëve, ose të këtë shprehur ndonjë qëndrim në këtë drejtim.

20. Ndërsa për pretendimin e cenimit të *parimit të mosdiskriminimit*, kërkuari ka pretenduar se është diskriminuar nga ILDKPKI-ja për shkak të përkatësisë fetare, politike dhe krahinore ose për shkak të detyrës që ka pasur, e cila e ka gjobitur dy herë atë në të njëjtat kushte, për të njëjtën arsye dhe pa asnjë shkak, pa asnjë shkelje. Edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe kushtetues e kanë diskriminuar kërkuarin, sipas tij, pasi ato në vijimësi rrëzojnë ose nuk pranojnë kërkesat e tij. Kolegji vëren se pretendimi i kërkuarit është i natyrës së përgjithshme dhe nuk është i argumentuar nga pikëpamja kushtetuese. Vetëm ngritja e pretendimit pa paraqitur shkaqe konkrete për të drejtën kushtetuese të pretenduar të cenuar, nuk përbën *per se* argument kushtetues në mbështetje të tij. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim nga Kolegji.

21. Për sa i takon pretendimit të kërkuarit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, ai ka pretenduar se gjykata administrative padrejtësisht ka miratuar vendimin e ILDKPKI-së, e cila e ka gjobitur kërkuarin, një subjekt që tashmë nuk është subjekt kontrolli nga ai institucion, në mënyrë të pakuptimtë, pa bazë ligjore dhe jashtë çdo afati. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit

kushtetues. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vet hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike lidhet në thelb me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, për rrjedhojë nuk hyjnë në sferën e juridiksionit kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim nga Kolegji. Ndërsa vetëm fakti se gjykata ka rrëzuar kërkesëpadinë e tij nuk është argument i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të krijuar dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të sigurisë juridike.

22. Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar edhe *shfuqizimin e nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive*, i cili parashikon se çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në atë ligj kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, ndërsa për shkelje të tjera të atij ligji, të konstatuara gjatë veprimtarisë kontrolluese, me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm mund të vendoset gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë. Ndërsa në *pikën 2 të urdhrit nr. 475/2023 të ILDKPKI-së* përcaktohen se cilat janë “shkeljet e tjera”, e cila gjithashtu kërkohet të shfuqizohet nga kërkuesi. Sipas tij, dispozita e ligjit është antikushtetuese, pasi askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes në bazë të nenit 32 të Kushtetutës, ndërsa urdhri është në shkelje të Kushtetutës, pasi nuk parashikon asnjë kriter për vendosjen e gjobës, si, për shembull, në rastin e kërkuesit duhej marrë në konsideratë fakti se ai nuk ishte më subjekt deklarimi ose që ai në kohën kur i është vendosur gjoba ka qenë i papunë.

23. Kolegji vëren se neni 32 i Kushtetutës u referohet garancive procedurale të parashikuara nga Kushtetuta për procesin penal dhe jo atë administrativ, siç është rasti i kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI-ja. Edhe gjykata e shkallës së parë i ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për antikushtetutshmërinë e dispozitës, duke arritur në konkluzionin se nuk ka arsye serioze për antikushtetutshmëri (*shih faqen 17 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Ndërsa për urdhrin e kundërshtuar, kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të tij, duke mos arritur të identifikojë as dispozitën kushtetuese të cenuar. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për shfuqizimin e nenit 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe pikës 2 të urdhrit nr. 475/2023 të ILDKPKI-së, që kanë shërbyer si bazë ligjore e vendimit nr. 14/2023 të ILDKPKI-së, është haptazi i pabazuar.

24. Për sa më lart, Kolegji do të analizojë pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk e ka arsyetuar vendimin e saj dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

26. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit të vendimit i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra të tilla që e bëjnë gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen konkrete, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se nga ana e organit administrativ është respektuar procedura për thirrjen e kërkuesit për t'u paraqitur e për të dhënë shpjegime për deklarimin e interesave privatë, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive. Po kështu, gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret është përmbushur barra e provës nga ana e organit publik për të evidentuar kryerjen e kundërvajtjes administrative. Konkretisht, sipas saj, me urdhrin nr. 783, datë 12.09.2022 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së është kryer kontrolli i plotë i deklaratave të interesave privatë “Periodik/Vjetor 2017”, “Periodik/Vjetor 2018”, “Pas largimit nga funksioni 2019” të kërkuesit. Me shkresat nr. 2782/25, datë 07.12.2022 dhe nr. 2782/25, datë 26.01.2023, vijon ajo, për shkak të problemeve të konstatuara nga kontrolli, është thirrur kërkuesi për sqarimin e problematikave dhe paraqitjen e dokumentacionit justifikues, i cili edhe pse ka marrë dijeni, nuk

është paraqitur për të dhënë shpjegime. Në këto kushte, bazuar në nenin 40 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe pikës 2 të urdhrit nr. 475/2023, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, me vendimin nr. 14/2023 ka vendosur masën administrative “gjobë” ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e asaj gjykate, detyrimi për t’u paraqitur për të dhënë shpjegime është kërkesë e nenit 27 të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe mosrespektimi i këtij detyrimi është parashikuar si kundërvajtje administrative në nenin 40 të ligjit dhe urdhrin e nxjerrë për zbatim të tij. Ajo gjykatë ka arritur në konkluzionin se vendimi nr. 14/2023 ishte i ligjshëm, i nxjerrë në zbatim të ligjit dhe në ushtrim të kompetencave ligjore të organit publik (*shih faqet 12-14 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

28. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përmban të dhënat e palëve, shkaqet e ngritura në kërkesëpadi, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Ai nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Gjithashtu, Kolegji konstaton se Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në kërkesëpadi nga kërkuesi, duke u dhënë atyre përgjigje në thelb dhe se arsyetimi i saj nuk duket të jetë haptazi i paarsyeshëm. Vetëm fakti se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuesit, nuk e bën *per se* gjykimin e padrejtë. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.